

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 E hënë, 3 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita dhe mirë se keni ardhur.

7 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Pikë së pari, u lutem të pranishmëve të prezantohen.

14 Znj. Prokurore, keni fjalën.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

16 Për ZPS-në është Line Pedersen, Filippo de Minicis edhe unë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Mbrojtës i Viktimave.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita. Më quajnë Simon Laws,

21 Mbrojtësi i Viktimave së bashkë me bashkëmbrojtësen Maria
22 Radziejowska.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar
2 Gjykatëse. Mirëdita. Ndodhemi këtu me z. Shala i cili na ndjek
3 nga qendra e paraburgimit. Mua më quajnë Jean-Louis Gilissen.
4 Ndodhem këtu bashkë me z. Hedi Aouini, bashkëmbrojtës; Judit
5 Kolbe, siç e njihni shumë, znj. Dzeneta Petravica, menaxhere e
6 lëndës. Faleminderit shumë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Z. Shala, a mund të na konfirmoni që më dëgjoni në
10 rregull?

11 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj shumë
12 mirë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull.

15 Sot do të vijojmë me kundrapyetjet që Mbrojtja do t'ia
16 bëjë z. Gasior. Përpara se të fillojmë me dëshminë e
17 dëshmitarit, do të lëshojnë një -- do të lëshojmë dy në fakt
18 urdhra gojarisht.

19 Ka disa shifra në të, kështu që do përpiqem që të flas
20 ngadalë.

21 I pari urdhër i lëshuar gojarisht ka të bëjë me një
22 kërkesë të cilën ZPS-ja e ka bërë me postë elektronike ditën e
23 martë, 27 qershor 2023, në orën 10.24, që ka të bëjë me
24 caktimin e një numri prove materiale, dokumentit me numër ERN
25 SPOE00214798 deri në 00214799.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 ZPS-ja parashton se ky dokument përbën versionin e saktë
2 të një raporti të cilin Trupi Gjykues e ka pranuar në provat
3 gjyqësore më 23 prill 2023 sipas vendimit të tij për mocionin
4 e Prokurorit të Specializuar për pranimin e provave shkresore
5 me numër F00491. Numri ERN i këtij raporti është SPOE00134047
6 deri në 00134048.

7 ZPS-ja parashton gjithashtu se raporti fillestar tani
8 zëvendësohet - nuk ekziston më në Legal Workflow - pra, është
9 zëvendësuar me versionin e saktë dhe kështu i kërkon Trupit
10 Gjykues t'i jap urdhër Trupit Gjykues t'i japë urdhër Zyrës
11 Administrative t'i caktojë një numër prove material versionit
12 të ri.

13 Duke marrë në konsideratë parashtrimet e ZPS-së Trupi
14 Gjykues e miraton kërkesën e ZPS-së dhe i jep urdhër Zyrës
15 Administrative t'i caktojë një numër prove materiale
16 dokumentit të kërkuar me numër ERN SPOE00214798 deri në
17 00214799, si edhe përkthimit në gjuhën shqipe.

18 Udhëzohet më tutje Zyra Administrative që të regjistrojë
19 në fushën "Komente të përgjithshme të dokumentit" këtë urdhër
20 të lëshuar gojarisht.

21 Këtu përfundon ky urdhër i parë i lëshuar gojarisht.

22 I dyti ka të bëjë me një kërkesë që Mbrojtja e ka bërë me
23 postë elektronike ditën martë, 27 qershor 2023, në 16.13, për
24 të shtuar një material në listën e materialeve që do të
25 përdoren gjatë kundrapyetjeve të cilat do t'ia bëj sot

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 Dëshmitarit me numër 04826.

2 Ne e dimë se ky material me numër ERN 113841 deri në
3 113843 ZPS-ja e ka nxjerrë ditën e hënë, 26 qershor 2023, me
4 paketën e nxjerrjes 136.

5 Duke qenë se nuk janë ngritur kundërshtime nga ZPS-ja dhe
6 Mbrojtësi i Viktimave, Trupi Gjykues e autorizon Mbrojtjen që
7 ta shtojë këtë material në listën e materialeve që do të
8 përdoren gjatë kundrapyetjeve të cilat do t'ia bëjë
9 dëshmitarit dhe udhëzon Mbrojtjen që ta ndryshojë listën e
10 materialeve dhe të përditësojë këtë listë në përputhje me
11 këtë.

12 Këtu mbyllet ky urdhër i dytë i lëshuar gojarisht kështu
13 që kjo do të thotë se do të vijojmë me dëshminë e z. Gasior.

14 Do të bëjmë tri seanca të rregullta nga një orë e gjysëm
15 sot. Pushimi parashikohet që të jetë ose 60 minuta, nuk e di
16 sesa kohë do të harxhojmë sot, po duhet të mbarojë sot, për
17 shkak edhe të disponibilitetit të përkthyesve të gjuhës
18 përkatëse. Po shikoj që nuk ka kundërshtim.

19 Z. Avokat i Mbrojtjes, ju lutem nëse mund të na tregoni
20 sesa kohë ju nevojitet pak a shumë, për afërsisht sigurisht?

21 Z. AOUIINI: [Përkthim] Faleminderit. Mirëdita, të nderuar
22 Gjykatës dhe të gjithëve të pranishmëve në sallë.

23 Sa i takon ritmit tonë mendojmë se do të përfundojmë
24 brenda një seance.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 Faleminderit shumë.

2 Një pyetje më teknike që dua të bëj, a po funksionon
3 transkripti për të gjithë? Është problem. Ne kemi vështirësi.

4 Znj. Prokurore.

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Pra, nuk po funksiononte një
6 moment. Tani po funksionon. Besoj se mbase po punohet për ta
7 zgjidhur këtë problem.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
9 nga ana e Mbrojtjes?

10 Z. AOUBINI: [Përkthim] Nga ana jonë funksionon, të nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. Do të komunikoj me Sekretaren e Gjykatës.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
15 këshillohen]

16 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
18 shoh, po përpara sesa të fillojmë preferoj që të kemi
19 transkriptin funksional për të gjithë. Një moment.

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
21 këshillohen]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
23 Avokat.

24 Z. AOUBINI: [Përkthim] A mund të kërkojmë një sqarim
25 ndërkohë? Mund të kërkojmë një sqarim?

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
2 mundet.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Në urdhrin e dytë që
4 lëshuat gojarisht, na është dhënë udhëzimi që ta ndryshojmë
5 listën. Po ne mendojmë që mbas nxjerrjes së listës është Zyra
6 Administrative ajo që i shton dokumentet nëse shtohen më pas.
7 Domethënë, duam të dimë nëse duhet ta bëjmë ne këtë gjë, se
8 mbase mund të mos kemi të drejtat për t'i shtuar këto dokument
9 sepse lista e materialeve për t'u përdorur është nxjerrë
10 ndërkohë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
12 ndjekim këtë por nga që është vetëm një dokument dhe nga që e
13 dimë për cilin dokument bëhet fjalë, nuk besoj se do të ketë
14 ndonjë problem.

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
16 këshillohet]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Avokat, është shtuar në listë. Pra, është rregulluar dhe kjo
19 punë.

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
21 këshillohen]

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
24 Trupin Gjykses, Transendi tani funksionon.

25 Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave kanë konfirmuar? Po,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 7

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 konfirmojnë. Në rregull. Atëherë mund të vazhdojmë me dëshminë
2 e dëshmitarit.

3 Znj. Asistente e Sallës, shoqërojeni dëshmitarin që të
4 hyjë në sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
7 ju lutem, z. Gasior.

8 Mirëmëngjes, z. Gasior. Dhe mirë se keni ardhur. Ju lutem
9 konfirmoni se më dëgjoni në rregull.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj shumë mirë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Shala, e keni dëgjuar përkthimin?

13 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ndëgjoj shumë mirë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Z. Gasior, si jeni sot?

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirë jam, faleminderit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Gasior, do të do të vijojmë me pyetjet të cilat do t'jua bëj
20 Mbrojtja.

21 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
22 vërtetën.

23 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, Znj. Kryetare e
25 Trupit Gjykses.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 8

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 DËSHMITARI: MAREK GASIOR [Vijon]

2 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

3 Pyetje të palës tjetër nga Z. Aouini:

4 Z. AOUBINI: [Përkthim]

5 PY. Mirëdita, Dr. Gasior.

6 PË. Mirëdita.

7 PY. Unë jam një prej avokatëve mbrojtës të z. Shala që është
8 i akuzuari në këtë çështje gjyqësore. Kam disa pyetje për të
9 hedhur dritë mbi disa hollësi dhe mbi disa përgjigje të cilat
10 ju ja keni dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar javën që
11 shkoi.

12 Do përpiqem që t'i bëj sa më shumë këto pyetje dhe
13 përgjigjet t'i bëjmë në seancë publike, kështu që do t'ju
14 lutesha që disa informacione t'i cekim duke thënë individit A,
15 individit B dhe individit C. Nëse nuk ju kujtohet me saktësi se
16 cilët janë këta persona, ju lutem na thoni që t'i sqarojmë në
17 mënyrë që të mos ngatërrohemi.

18 PË. Individit A --

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
20 lutem, z. Gasior, mos e thoni emrat se jemi në seancë publike.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Pacienti A, individit A është ai,
22 kufomës së të cilit ja bëra autopsinë. Individët B dhe C janë
23 dy individë, pacientë siç i themi, të cilit i kam këqyrur
24 fizikisht. Pra, u kam bërë një këqyrje fizike të trupave të
25 tyre.

1 Z. AOUINI: [Përkthim]

2 PY. Pikërisht kështu është.

3 Atëherë, z. Doktor, do të fillojmë sot me individin A dhe
4 këqyrjen që ia keni bërë këtij individ.

5 Të hënën që shkoi, në faqen 2075, rreshtat 17 deri në 23,
6 po flitej këtu për situatën, gjendjen, në të cilën ndodhej
7 kufoma dhe materialet që keni marrë në qesen përkatëse për të
8 bërë autopsinë. Dhe në veçanti, ju thatë se gjetët aty një
9 pjesë gipsi. Ju kujtohet?

10 PË. Siç e thashë edhe javën që shkoi, autopsia e këtij
11 individ u krye [REDAKTUAR], u përpilua dhe
12 procesverbali në bazë të punës time, pra, të kësaj autopsie të
13 cilën e kam përpara meje, por autopsia, vetë autopsia dhe, më
14 vjen keq, domethënë, [REDAKTUAR], vetë autopsia nuk më
15 kujtohet.

16 Tani që t'i përgjigjem pyetjes, këtu nga dokumenti, nga
17 raporti që kam përpara, del se pacienti në këmbën e djathtë
18 kishte vërtetë gips.

19 PY. Faleminderit. Nuk dua që të mbajmë mend gjithçka. Po nëse
20 ka hollësi do t'ju them veçanërisht që të lexoni raportin.

21 Unë thjesht ju pyeta nëse ju kujtohet nëse ka pasur gips
22 apo jo dhe ju e konfirmuat. Dhe mund të vazhdojmë përpos nëse
23 keni ndonjë saktësim që doni ta bëni.

24 PË. Në raport lexojmë se ky gips ishte përdorur për t'i
25 mbështjellë këmbën apo gjymtyrën e djathtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 10

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 PY. Z. Doktor, ky gips ishte përdorur vetëm për një pjesë të
2 këmbës apo për të gjithë këmbën?

3 PË. Mund t'i përgjigjem kësaj pyetjeje duke u mbështetur në
4 fotografitë që përmban raporti.

5 Z. AOINI: [Përkthim] Mbase është fotografia numër 12, me
6 numër ERN 0031062.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
8 Sekretare, ju lutem mund ta shfaqni në ekran.

9 Z. AOINI: [Përkthim] Të mos i transmetohet publikut
10 natyrisht.

11 PY. Z. Doktor, mund të shikoni fotografinë 12 dhe mund të
12 konfirmoni nëse e keni fjalën për këtë gips që ishte përdorur
13 për një pjesë të këmbës pjesën e poshtme të këmbës apo ishte
14 përdorur për të gjithë këmbën?

15 PË. Kur shohim fotografinë numër 11, ajo që shohim është
16 pjesa e pasme e trupit. Pra, në tryezën e autopsisë është
17 vendosur shtrirë kufoma përmbys.

18 Sa i takon fotografisë 12, shohim gipsin në fjalë. Këtë
19 na tregon ky raport.

20 PY. Z. Doktor, a keni identifikuar nga materialet që keni
21 marrë në qese ndonjë pajisje, element apo material tjetër i
22 cili do të tregonte që i është bërë trajtim? Ju kujtohet?

23 PË. Është mbështjellësja prej gipsi në këmbën djathtë dhe po
24 kështu, kishte dhe një kateter, së bashku me një qese,
25 sigurisht është pajisje që përdoret për nxjerrjen e urinës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 11

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 PY. Faleminderit. Po të shohim faqen në vijim, fotografinë 15
2 dhe 16 për t'u përputhur me përshkrimin e fotografive, nëse
3 mundet.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Mundet.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Është me numër 037063 fotografitë
7 15 dhe 16.

8 PY. Doktor, shohim fotografinë 15 dhe 16 për këtë e keni
9 fjalën kur thatë kateter? E konfirmoni?

10 PË. Ky është pjesë e kateterit. Dhe përfundon me atë qesen
11 për nxjerrjen e jashtëqitjeve, pra dhe është përdorur ky
12 kateter.

13 PY. Te përshkrimi që është bërë në raport, në faqen 031050,
14 përmendet, kjo është vetëm për sqarim:

15 "'Qese me tuba' që të çojnë në rrugët urinare" dhe është
16 pikërisht fotografia 15, 16, 18, 19, 20, 21 dhe fotografia 57
17 tregon "Qesen që është hequr". Dhe këtu e kemi fjalën për
18 kateterin?

19 PË. Përshkrimi është për kateterin, po, për kateterin bëhet
20 fjalë.

21 PY. Faleminderit. Që ta sqarojmë edhe më tej, a mund t'i
22 shpjegoni Trupit Gjykses çfarë është një kateter, për ne që
23 nuk jemi të fushës së mjekësisë, a mund të na e shpjegoni për
24 çfarë shërben kateteri?

25 PË. Është një tub që futet në rrugët urinare, në fshikëzën e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 12

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 urinës, pra dhe përdoret për nxjerrjen e urinës dhe urina
2 futet në një qese plastike që është jashtë trupit të njeriut.
3 PY. Faleminderit, doktor. Të shohim një pjesë tjetër të këtij
4 raporti që bëhet fjalë për sapunëzimin, pjesa ku flitet për
5 sapunëzimin. Sapunizimi i trupit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
7 mund të heqim fotografitë Avokat?

8 Z. AOUINI: [Përkthim] Po mund t'i heqim.

9 PY. Doktor, na treguat si ndodh procesi i sapunëzimit në
10 faqen 2074 deri në 2075 të transkriptit. Po aty përmendët se
11 në këtë rast për shkak të trupit të individit A, të gjitha
12 indet e buta ishin sapunëzuar, kështu? Ju kujtohet?

13 PË. Te raporti thuhet se indet e buta të personit A, ishin
14 transformuar pas shpërbërjes së trupit pas vdekjes. Prandaj
15 kishte ndodhur transformimi i dhjavit dhe quhet si procesi i
16 sapunëzimit. Ju thashë, në qoftë se ju kujtohet, që quhet edhe
17 transformimi shkumës, si shkumës.

18 PY. Ju kujtohet në qoftë se nga trupi kishte mbetur thjesht
19 skeleti?

20 PË. Pjesërisht. Po, pjesërisht kishte mbetur vetëm skeleti
21 dhe pjesërisht indet e buta të individit A ishin sapunëzuar.

22 PY. Faleminderit, për sqarimin. A mund të themi se asnjë ind
23 i butë nuk kishte mbetur në trup?

24 PË. Në trupin e pacientit A kishin mbetur inde të buta të
25 cilat ishin transformuar pas vdekjes, *post-mortem*, pra, ishin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 13

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 transformuar në procesin që ne e quajmë sapunizim, në atë që
2 ne e quajmë sapunizim.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykues do donim
4 që të paraqesim në ekran materialin që sapo shtuam për të
5 sqaruar një fjali dhe t'i japim mundësinë doktorit që të japi
6 sqarimet e veta lidhur me këtë aspekt konkret.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Patjetër. Mund t'i jepni numrin ERN Sekretares, në mënyrë që
9 ta vendosë në ekran.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, ERN 113841 deri në
11 113843 dhe na duhet faqja e parë e këtij materiali. Nuk duhet
12 transmetuar për publikun. Dhe na duhet pika numër 2, poshtë c,
13 poshtë shkronjës c. Shkronja konkrete c.
14 PY. Doktor, a mund ta lexoni? Këtë thuhet tek c: "Në trup nuk
15 kishin mbetur inde të buta". Kjo është vetëm për sqarim. A
16 mund të na shpjegoni se çfarë keni dashur të thoni me këtë
17 fjali?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dua t'i them që Avokati po flet
19 për vetëm një fjali të raportit, por ka dhe një pikë më lart
20 në këtë raport ku ka informacion lidhur me procesin e
21 sapunëzimit në veçanti. Unë mund ta lexoj, po këtë mund ta
22 shohim të gjithë. Kështu që mendoj që eksperti duhet t'i
23 lexohen të dyja këto pika në mënyrë që t'i sqarojë tamam se
24 për çfarë dhe të marrim përgjigjen që na nevojitet ne.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Mendoj që për ta bërë pyetjen e plotë mendoj që duhet ta
3 lexojmë edhe këtë pikë, megjithatë mendoj që duhet ta lexojmë
4 edhe këtë pikë, megjithatë mendojmë që eksperti është në
5 dijeni të materialit. Sidoqoftë për transkript duhet t'i
6 lexojmë të dyja.

7 Z. AOUINI: [Përkthim]

8 PY. Atëherë pika b thuhet:

9 "Skeletonizim do të thotë që nuk ka mbetur mish në trup,
10 lëkura ishte transformuar dhe saponizuar".

11 Dhe pika c lexon:

12 "Nuk kishin mbetur inde të buta në trup në kufomë".

13 Doktor, a mund të na sqaroni të gjithëve çfarë keni
14 dashur të thoni me këto fjali sa i takon kufomës së individit
15 A?

16 PË. Gjatë këqyrjes pas vdekjes, pas zhvarrosjes së trupit,
17 indet e buta ishin hequr dhe pjesa e indeve janë vendosur në
18 tryezën e autopsisë në pozicion anatomik dhe bëhet këqyrja për
19 të vërtetuar nëse kishte lëndime në skelet. Prandaj, për të
20 këqyrrur skeletin, mbetjet, pra, të skeletit, u hoqën indet e
21 buta, ju hoqën skeletit indet e buta.

22 PY. Fotografia që kemi në raport është fotografi e kufomës
23 pasi u vendos në pozicionin anatomik, kështu?

24 PË. Cila fotografi?

25 Z. AOUINI: [Përkthim] Fotografia numër 11 me ERN 031062,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 15

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 ose të gjithë faqen basë në 031056, mund ta shohim të gjithë
2 faqen.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem, Sekretare, ta vendosim në ekran.

5 Z. AOUINI: [Përkthim]

6 PY. Doktor, për këtë e keni fjalën kur thatë pozicioni
7 anatomik?

8 PË. Po, është fotografia e pacientit pasi i është dorëzuar
9 morgut për të kryer autopsinë.

10 PY. Faleminderit. Do ju kërkoj edhe disa sqarime lidhur me
11 një pikë tjetër të raportit tuaj që bëhet fjalë për gjuajtjet
12 me armë të cilat keni vërejtur në trup në kufomë.

13 Pyetja është si në vijim: A mund të na konfirmoni se në
14 raport ku thuhet dy deri tre plagë plumbi dhe javën e kaluar
15 thatë që mendimi juaj ishte se kishte tre gjuajtje me armë
16 zjarri, a konfirmoni se nuk u bë asnjë matje e vrimave, pra,
17 dhe nuk është përmendur kjo në raport?

18 PË. Gjatë këqyrjes të mbetjeve të skeletit, ku ishin tre
19 plagë plumbi në gjurin e djathtë, nga të cilat dy kanë hyrë
20 mes për mes gjurit, pra, në kupën e gjurit, në kockën e gjurit
21 dhe gjuajtja e tretë, e shtëna e tretë, plaga e tretë, pra, ka
22 qenë tangjentiale, gjuajtje tangjentiale, pra, sipërfaqësore.

23 PY. Faleminderit. Më dëgjoni. Unë po ju pyesja u bë ndonjë
24 matje e diametrit të vrimave që u panë, që u këqyrën në
25 kufomë. Shohim që në raportet përmenden ndonjëherë matje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 16

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 centimetra, milimetra, por për këtë nuk shohim asnjë lloj
2 matje. A e konfirmoni këtë?
3 PË. Në këtë raport, sa u takon lëndimeve të dukshme në kockë
4 të shkaktuara nga arma e zjarrit është bërë një matje e rrezes
5 me numër, pra, është bërë një matje në milimetra.

6 PY. Doktor, shohim një legjendë në fotografi por s'kemi të
7 njëjtat matje si në pjesën tjetër të raportit ku ka dhe
8 shigjetat, shifra të sakta, as tek përshkrimi nuk flitet për
9 diametrin e vrimave në kockë. Thjesht po përpiqem ta sqarojë.
10 Ka apo nuk ka në raport një matje të tillë?

11 PË. Për të vërtetuar dëmin gjithmonë bëhet një matje me
12 milimetra, kjo është me vizore, pra, është një vizore me
13 milimetra që përdoret për të përcaktuar sa ka qenë përmasa e
14 plagës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj
16 se mund të shohim faqen 0310365 dhe fotografinë 29, mbase për
17 këtë e ka fjalën dëshmitari. Sigurisht nuk doja t'ju
18 ndërprisja, po kam përshtypjen që dëshmitari për këtë
19 fotografi e ka fjalë mund ta pyesim nëse e konfirmon këtë gjë.
20 Dhe të mbajë fotografinë përpara kur të bisedojë me të.

21 Z. AOINI: [Përkthim] Po. Atëhere ERN 031065 fotografa
22 30. Për të kuptuar nëse po flasim për të njëjtën fotografi.

23 PY. Doktor, vizorja --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Ndjesë, ndjesë që po ju ndërpres prapë. Keni një pikë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 17

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 paqartë në transkript dhe do të kisha dashur ta sqaronim.

2 Në faqen 14, 1 dhe 4, z. Gasior flet për një plagë të tretë,

3 shikoj "e shtënë tangjentile" "sipërfaqësore".

4 A mund të na e sqaroni z. Gasior për çfarë e keni fjalën?

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Është një e shtënë me armë zjarri,

6 plagë plumbi, e cila hyn në fibia dhe në nyellin e kockës së

7 femurit anash. Kjo plagë është e dukshme në fotografinë numër

8 39.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Atëherë për Sekretaren bëhet fjalë për materialin me numër

11 031067.

12 Z. AOUINI: [Përkthim]

13 PY. Doktor, e keni fjalën për shigjetën me ngjyrë të gjelbërt

14 aty?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] 39,

16 po.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Po është një shigjetë që ngjan me

18 ngjyrën e gjelbërt, i afrohet ngjyrës së gjelbërt.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit për sqarimin.

21 Po ia kaloj sërish fjalën Avokatit Mbrojtës.

22 Z. AOUINI: [Përkthim]

23 PY. Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

24 PY. Dhe faleminderit, Doktor për sqarimin.

25 Ju na thatë, që për mendimin tuaj, koha mes gjuajtjes me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 18

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 armë zjarri dhe vdekjes ka qenë e shkurtër. Në transkript
2 është thënë kjo në faqen 2095, rreshtat 4, 5 dhe në vijim. Dhe
3 sipas jush ishte shkatërruar arteria dhe pati gjakderdhje që
4 shkaktoi edhe vdekjen, sepse nuk tregon që ka pasë shenjë të
5 shërimit të plagës. Pra, në vlerësimin tuaj, koha nga gjuajtja
6 me armë zjarri e deri në vdekjen e personit ka qenë e
7 shkurtër.

8 A mund të na ndihmoni dhe të na thoni si e vlerësoni ju,
9 pra, sa e shkurtër ka qenë kjo kohë nga momenti që është
10 gjuajtur deri në momentin që vdiq, sa ka qenë koha?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 [Mikrofoni çaktivizuar]

13 Vazhdoni, z. Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Këqyrja e kockave të dëmtuara nuk
15 tregoi se kishte pasur shërim apo rikuperim, prandaj koha nga
16 lëndimi që pësoi pacienti e deri në momentin që vdiq ka qenë e
17 shkurtër.

18 Koha për shërim varet nga shumë faktorë, ndër të cilët
19 mosha e pacientit, faktorë personalë, të cilët luajnë një rol
20 shumë të rëndësishëm. E vetmja gjë që unë mund të përsëris
21 është që ka qenë kohë e shkurtër.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
23 lejoni t'ju bëj një pyetje. Kur thoni "kohë e shkurtër", z.
24 Dëshmitar, e keni fjalën për ditë, a e keni fjalën për javë, a
25 e keni fjalën për muaj?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 19

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Orë, minuta?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
3 mundeni të na e jepni këtë vlerësim, sepse për ne është një
4 koncept shumë i vagullt.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë do thoja se qameti, maksimumi,
6 ka qenë pak ditë. Pak ditë.

7 Z. AOUINI: [Përkthim]

8 PY. Edhe ky është rasti edhe nëse plagët lihen të pa
9 mjekuara?

10 PË. Në fotografi, te fotografia ku duken kockat e dëmtuara
11 nuk ka asnjë shenjë të dukshme shërimit, çka tregon se koha nga
12 lëndimi e deri te vdekja ka qenë e shkurtër.

13 PY. A pajtoheni me mua se shkatërrimi i një nga arteriet
14 kryesore, sikurse dhe këtu është një situatë që vërtetë e
15 vendos në rrezik jetën?

16 PË. Dëmtimi i asaj arterie është vërtetë lëndim që është
17 kërcënim për jetën.

18 PY. Faleminderit. Do shohim një raport tjetër. Do flasim tani
19 për individin B. Një raport tjetër i këqyrjes që i është bërë
20 individit B.

21 A keni nevojë t'i hidhni një sy për ta kuptuar se cili
22 është individi B? Jemi në seancë publike, kështu që nëse ju
23 nevojitet kohë thjesht na informoni dhe ne me kënaqësi do
24 t'ju plotësojmë këtë kërkesa.

25 PË. Kur flisni për personin B, e keni fjalë për raportin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë private)

Faqe 20

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 [REDAKTUAR] në raport?

2 PY. Po, doktor.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
4 kisha dashur që të kalonim një çast në seancë private që ta
5 themi emrin dhe pastaj kalojmë prapë në seancë publike që të
6 mos kemi dhe keqkuptime.

7 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë private?

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasiar (Vijon) (Seancë private)

Faqe 21

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] kështu? Mjaft të thoni po

17 ose jo.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit për sqarimin.

21 Avokat, mund të vazhdoni tani.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Doktor, javën e kaluar në faqen 2120, ju thatë, folët për

24 një plagë në kokë dhe thatë që kjo plagë i përkon supozimit që

25 individi B ka pësuar një traumë apo lëndim me një send.

1 Dhe pyetja ime është: A mund të themi që mund të jetë
2 goditur edhe me një shishe qelqi, shishe qelqi si ajo e Coca-
3 Cola, a mund të themi dhe këtë?

4 PË. Këqyrja e pacientit është kryer me datë [REDAKTUAR]
5 [REDAKTUAR]. Pacienti, në një intervistë në të, tha se këto
6 ishin plagë që i ishin shkaktuar në vitin 1999. Pra, që këto
7 ishin plagë që i kishte pasur [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]. Gjatë procesit të këqyrjes ne mund të shikonim
9 shenja të mbetura ose njolla të mbetura nga plagët dhe të
10 cilat janë të përshkruara në raportin tim.

11 PY. Shumë faleminderit, doktor. A e kuptojmë drejt që është e
12 pamundur të përcaktohet përfundimisht se cili ka qenë shkaku i
13 plagës së pësuar nga pacienti. A jeni dakord me këtë formulim
14 timin?

15 PË. Plagët e përshkruara kanë ardhur si rezultat i një
16 traume.

17 PY. Ne folëm ose më mirë juve folët edhe për një plagë që
18 kishte në shpatull pacienti. Kjo përmendet në faqen 2121 të
19 transkriptit i të martës të javës që shkoi. A jeni dakord me
20 mua, pajtoheni me mua dhe lidhur me këtë që është e pamundur
21 të përcaktohet se kush ka qenë burimi i kësaj plage ose çfarë
22 e ka shkaktuar këtë plagë në shpatullën e pacientit.

23 PË. Këto plagë të cilat kanë lënë si pasojë shenjat e dukshme
24 tek pacienti kanë ardhur si rezultat e një traume.

25 PY. Në rregull. Nuk dua të jem i padrejtë me ju, doktor. Bie

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 23

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 dakord me juve që bëhet fjalë për një plagë ose një shenjë të
2 mbetur nga një traumë, por ajo çfarë po them unë është që
3 është e pamundur që të përcaktohet me saktësi se çfarë e ka
4 shkaktuar këtë shenjë të mbetur nga plaga ose nga trauma,
5 kështu?

6 PË. Ne mund të flasim vetëm për sa më poshtë. Shenjat kanë
7 ardhur si rezultat i një traume që ka vuajtur ose që ka kaluar
8 pacienti.

9 PY. Tani le të flasim për plagën e tretë, për plagën që ka në
10 këmbë pacienti, ju na thatë javën që shkoi dhe kjo për
11 procesverbal ishte në faqen 2123 të transkriptit që shenja
12 ishte "Shumë e modifikuar ose e ndryshuar". Pyetja që kam për
13 ju është kjo: Edhe në këtë rast sa i takon kohës dhe
14 ndryshimit të shenjës së plagës, juve nuk mund të përcaktoni
15 me saktësi se çfarë e ka shkaktuar këtë shenjë ose çfarë ka
16 shkaktuar këtë plagë që më pas ka lënë shenjën përkatëse tek
17 pacienti, kështu?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

20 Prokurore, a është e nevojshme që t'i kërkoj dëshmitarit që të
21 dalë nga salla apo jo?

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, thjesht dua që të bëhet një
23 korrigjim sepse kolegu im foli për plagën në këmbë.

24 Megjithatë, javën që shkoi në faqen që përmendet transkriptet
25 kolegu, eksperti po fliste për pjesën e këmbës. Kështu që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 24

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 thjesht, domethënë, mund ta kontrollojmë dhe një herë tjetër
2 në procesverbal, por për këtë e kishte fjalën doktori.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] ju kërkoj ndjesë, të nderuar
4 Gjykatës, ishte faji im. Domethënë, bëmë edhe një diskutim dhe
5 javën që shkoi lidhur me vendin e plagës por kolegja ka të
6 drejtë. Domethënë, e kam fjalën për plagën në pjesën e këmbës.
7 Kështu që është e vështirë që të përcaktojmë me saktësi se ku
8 ishte kjo plagë apo jo?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 lutem, formulojeni në pyetje.

11 Z. AOUINI: [Përkthim]
12 PY. A është e mundur që të përcaktohet në mënyrë shteruese se
13 kush ka qenë shkaku i kësaj plage, pra, nga çfarë është
14 shkaktuar kjo plagë, është e mundur të përcaktohet kjo me
15 saktësi?

16 PË. Po. Kjo plagë është shëruar dhe kjo plagë ka ardhur si
17 rezultat i një traume të mëparshme.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Nëse më lejoni, të nderuar
19 Gjykatës, dëshiroj që të përqendrohem tek një fotografi
20 konkrete dhe dua t'i bëj disa pyetje dëshmitarit lidhur me
21 këtë fotografi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Lidhur me cilën temë?

24 Z. AOUINI: [Përkthim] E kam fjalën tani për këmbën e
25 individit B.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

2 Vazhdoni më tej.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Atëherë do të shikojmë të njëjtin
4 raport, është raporti ne numër identifikimi SITF0019134 deri
5 në SITF00019147, po shohim fotografinë në faqen 9, fotografinë
6 në fillim të faqes 9, në qoftë se nuk e kam gabim.

7 Në fakt bëhet fjalë për fotografinë në të djathtë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
9 mund të zbardhet pak kjo foto?

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Kam përshtypjen se është e
11 selektuar fotografia. Në qoftë se ç' selektohet mendoj që
12 ngjyrat mund të ndryhen pak dhe mund të bëhet pak më të
13 zbardhura.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mjafton me kaq është në rregull.

16 Ju lutem vazhdoni, Avokat.

17 Z. AOUINI: [Përkthim]

18 PY. Doktor, nga këqyrja e shenjës që ka pacienti në këmbë a
19 mund ta përcaktoni në qoftë se bëhet fjalë për një plagë të
20 rëndë? Sipërfaqësore? Mesatare? A mund të bëni një cilësim,
21 një përshkrim të plagës çfarë lloj plage ka qenë?

22 PË. Ishte një plagë që ka mbuluar indet, indet e buta.

23 PY. Po kjo plagë a mund të përshkruhet si plagë sipërfaqësore
24 është e mundur kjo gjë?

25 PË. Gjatë procesit të këqyrjes pacienti është informuar se ai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 26

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 duhet që të bënte fotografi me skaner të këmbës në mënyrë të
2 tillë që të përcaktohej nëse bëhej fjalë për plagë të pjesës
3 së skeletit të këmbës së tij.

4 [REDAKTUAR] ai erdhi edhe një
5 herë në ambientet e Institutit Mjeko-Ligjor dhe solli një
6 fotografi me skaner të këmbës së tij ku nuk viheshin re
7 dëmtime të pjesës së skeletit të pjesës të skeletit të këmbës
8 së pacientit. Kjo do të thotë se kjo plagë konkrete ka cekur
9 vetëm indet e buta.

10 PY. Faleminderit, doktor. A të ka thënë individ B, pacienti,
11 ose persona të tjerë persona që e kanë sjellë këtë individ tek
12 juve që janë bërë skanime edhe në herë të tjera përpara sesa
13 ai të vinte përpara jush dhe të bënte këtë këqyrje dhe që
14 rezultatet kanë qenë negative. A të ka thënë njeri gjë lidhur
15 me këtë?

16 PË. Pacienti për të cilin po flasim është sjellë në ambientet
17 e Institutit Mjeko-Ligjor nga dy oficerë policie të cilët kanë
18 qenë të pranishëm në ambientet e Institutit Mjeko-Ligjor, po
19 nuk kanë qenë të pranishëm kur është bërë këqyrja e pacientit.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se do të më lejoni, të
21 nderuar Gjykatës --

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Përgjigjja nuk kishte përfunduar.
23 Këqyrja e pacientit është kryer [REDAKTUAR] dhe pacienti
24 është informuar për nevojën e bërjes së fotografive të këmbës
25 përmes skanerit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 27

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 Shënimi dhe raporti që është përpiluar gjatë këqyrjes së
2 dytë thotë që këto foto më të specializuara janë bërë

3 [REDAKTUAR]

4 PY. Në fakt, pyetjen unë do ta bëja lidhur me vitin po ju
5 sapo e sqaruat këtë. Thatë që bëhet fjalë për [REDAKTUAR],
kështu?

6 PË. Po, data që na u dha [REDAKTUAR]

7 Z. AOUIINI: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës,
8 a mund të kaloj në një dokument që cek informacion që ka të
9 bëjë me ekzaminim të mëparshëm për këtë çështje për
10 procesverbal, për ta hedhur në procesverbal.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
12 mund ta bëjmë këtë gjë. Por do ju këshilloja që të mos
13 përmendni data.

14 Z. AOUIINI: [Përkthim] A mund të paraqitet në ekran
15 dokumenti SITF00372733. Të shkojmë tek faqja e dytë e këtij
16 dokumenti, ju lutem. Faqja është SITF00372734. Atëherë numri
17 ERN që kam unë është SITF00372734.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] 34,
19 po ndërkohë unë shikoj numrin që përfundon me 24.

20 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
21 këshillohen]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Z. AOUIINI: [Përkthim] Nuk ka problem, të nderuar
25 Gjykatës. Mund të vazhdojmë më tej.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 28

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 PY. Përsëri, doktor, a ishit të informuar juve atëherë që
2 përpara sesa t'ju silleshin fotografitë me skaner në atë datën
3 që përmende më përpara që ishin bërë skanerë të tillë me
4 këmbën e pacientit, pra, dhe një herë pyetja është në qoftë se
5 individi B apo oficerët e policisë që e shoqëruan atë, ju kanë
6 thënë që ai ka bërë analiza të tilla dhe më përpara, më herët
7 datës së përmendur?

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Do kërkoja
9 që kolegu të japë referencën e analizës së bërë më përpara.
10 Sepse nuk jemi të sigurtë që po e ndjek në atë çka po thotë
11 kolegu.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit, znj. Prokurore.

14 E ndjek pyetjen tuaj, por edhe unë do t'ju bëja të
15 njëjtën pyetje, nëse është e mundur që të na thoni se cila
16 është referenca e dokumentit, në qoftë se ju duhet ca kohë që
17 ta gjeni këtë dokument nuk ka problem na e thoni.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
19 Unë po lexoj numrin ERN që kam këtu përpara. Ndoshta ka
20 ndryshuar, megjithatë numri që kam unë përpara është
21 SITF00372733 deri në SITF00372734. Është një dokument që
22 përmban dy faqe. Dhe informacioni jepet në fund të këtij
23 dokumenti.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do i
25 kërkoj Sekretares që të kontrollojë dhe njëherë dhe të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 29

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 verifikojë në qoftë se ekziston dokumenti me detajet që sapo
2 na dhatë.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] E kuptoj se cili është problemi se
4 nuk është në listën tonë dokumenti. Është në sistemin e
5 Gjykatës në *Legal Workflow* po nuk është në listën tonë. Janë
6 dokumente provuese. Por përderisa nuk e kemi si pjesë të
7 listës mund t'jua dërgoj edhe më pas.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
9 pajtohem me faktin se duhet të tregohet ky dokument se po
10 flasim për të, po diskutojmë për të, kështu që do i kërkoj dhe
11 Prokurorisë edhe Mbrojtësit të Viktimave që të na thotë se
12 çfarë mendon lidhur me këtë. Megjithatë nuk mendoj se ka
13 ndonjë problem që të vazhdoni me pyetjen tuaj në këtë çast.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi
15 kundërshtim. Sigurisht, që ne na duhet ta shikojmë dokumentin.
16 Megjithatë mund ta gjejmë dhe vetë për momentin, kështu që nuk
17 kemi problem me kolegun që të vazhdojë të bëjë një pyetje.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk jemi kundër me vazhdimin e
19 pyetjeve nga Avokati.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishte
21 pak e shpejtë në vendimin që mora.

22 Megjithatë do t'i kërkoja Sekretares së Gjykatës që ta
23 kontrollojë këtë dokument në sistemin *Legal Workflow* dhe të na
24 e paraqesë në ekran.

25 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për këtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Marek Gasior (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar
në bazë të F631 Faqe 30

Pyetje të palës tjetër nga z. Aouini

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F560RED dhe F631.

1 Është në fund të dokumentit dhe në faqen tjetër në
2 paragrafin e fundit. Në qoftë se do më kërkoni që ta lexoj do
3 të duhet që të kalojmë në seancë private.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull.

6 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

7 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në
8 bazë të F631

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 jemi në seancë private.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Z. Avokat, vazhdoni.

13 Z. AOUINI: [Përkthim] Shumë faleminderit, të nderuar
14 Gjykatës.

15 PY. Doktor, do t'jua lexoj këtë informacion dhe unë ju pyeta
16 më përpara në qoftë se ju jeni vënë në dijeni të
17 informacionit, pra, në qoftë se individ B a po dikush tjetër
18 ua ka dhënë këtë informacion.

19 Në raport thuhet:

20 "Duhet që të sqarohet në qoftë se është bërë, janë bërë

21 analiza me skaner më [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR] dhe si rezultat ato ishin të

